



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 1227/11prot.

Datë 15.08.2024

**V E N D I M**

**Nr. 1070/2024**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

|                  |         |
|------------------|---------|
| Jonaid Myzyri    | Kryetar |
| Fiorent Zguro    | Anëtar  |
| Kreshnik Ternova | Anëtar  |
| Gjergj Mersini   | Anëtar  |

Në mbledhjen e datës 15.08.2024 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:**

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e operatorit ekonomik “TRIMED” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar – Mallra – Prokurim me mjete elektronike, Marrëveshje kuadër me një operatorë ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat 12 muaj nga nënshkrimi”, me Nr. REF-97716-03-07-2024, me objekt: “Blerje materiale konsumi mjekesore per 12 Muaj e ndare ne 2(dy) lote” Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: 54.589.104 (pesedhete e kater million e peseqind e tetedhete e nente mije e njeqind e kater) leke pa T.v.sh e konvertuar në Euro, sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, datë 07.03.2024: 525.552 euro pa TVSH, Loti 1 me Nr. REF-97720-03-07-2024, me objekt: “Loti 1 - Materiale mjekimi te pergjithshme per nevoja spitalore”, me fond limit LOT I MM1: 25.735.020 (njezete e pese milion e shtateqind e tridhete e pese mije e njezete) leke pa TVSH e konvertuar në Euro, sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, datë

07.03.2024: **247.762 euro pa TVSH**, zhvilluar në datë 08.04.2024 nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Durrës.

**Ankimues:**

Bashkimi i Operatorëve ekonomikë “MONTAL” SHPK me NIPT J62009007F dhe me adresë Rruga Dervish Hima-3 Kullat, K3, A9/2, Tiranë & BIOMETRIC ALBANIA SHPK me NIPT J61827062E dhe me adresë Bulevardi Zhan D'ark, Pallati 53, Ap 6b, Tiranë.

**Autoriteti Kontraktor:**

Spitali Rajonal Durres me adresë Lagjia Nr.8, Rr.A.Goga , Durrës.

**Subjekte të Interesuara:**

Operatori ekonomik “TRIMED” SHPK me NIPT K51612031J dhe me adresë Kashar Tirane Kashar, KASHAR, Autostrada "Tirane -Durres", Km 10, Zone Kadastrale 2105, Nr.Pasurie 95/11.

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr.766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**V ë r e n:**

**I**

*Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

## II

### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 08-03-2024 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar – Mallra – Prokurim me mjete elektronike, Marrëveshje kuadër me nje operatorë ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat 12 muaj nga nënshkrimi*”, me Nr. REF-97716-03-07-2024, me objekt: “**Blerje materiale konsumi mjekesore per 12 Muaj e ndare ne 2(dy) lote**” Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: **54.589.104** (pesedhjetë e kater million e peseqind e tetedhjetë e nente mije e njeqind e kater) leke pa T.v.sh e konvertuar në Euro, sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, datë 07.03.2024: **525.552 euro pa TVSH, Loti 1 me Nr. REF-97720-03-07-2024**, me objekt: “**Loti 1 - Materiale mjekimi te pergjithshme per nevoja spitalore**”, me fond limit **LOT I MM1: 25.735.020** (njetë e pese milion e shtatëqind e tridhjetë e pese mije e njetë) leke pa TVSH e konvertuar në Euro, sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, datë 07.03.2024: **247.762 euro pa TVSH**, zhvilluar në datë 08.04.2024 nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Durrës.

II.2. Në datën 08.04.2024 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objektshqyrtimi.

II.3. Në datën 07.05.2024 autoriteti kontraktor ka kryer vlerësimin dhe ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

|                                   |                    |             |
|-----------------------------------|--------------------|-------------|
| 1- TRIMED                         | 23.456.273 lekë    | Kualifikuar |
| 2- BOE MONTAL & BIOMETRIC ALBANIA | 24,939,520.00 lekë | Kualifikuar |

II.4. Në datën 09.05.2024 është publikuar “Njoftim Fituesit paraprak” në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 24, datë 13.05.2024.

II.5. Në datën 17.05.2024 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2024/4099, si dhe nr. protokollit 1227/2024 datë 17.05.2024 e bashkimit të Operatorëve ekonomikë “MONTAL” SHPK & BIOMETRIC ALBANIA SHPK, duke kundërshtuar vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Trimed” SHPK.

II.6 Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 1227/2 prot. prot., datë 20.05.2024 janë publikuar kriteret për të cilat operatori ekonomik ankimes, pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “TRIMED” SHPK, pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

II.7. Në datën 23.05.2024 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar Formulari i paraqitjes së argumentave nga operatori ekonomik “TRIMED” SHPK, si subjekt i interesuar dhe pjesëmarrës në procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.8. Autoriteti Kontraktor me shkresën me nr. 28.05.2024, me nr. 782/3 prot., protokolluar me tonën 1227/4 datë 03.06.2024 ka vënë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, lidhur me vlerësimin e ankesës së paraqitur nga BOE “MONTAL” SHPK & BIOMETRIC ALBANIA SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit, ku rezulton, se autoriteti kontraktor nuk e ka pranuar, ankesën.

II.9. BOE “MONTAL” SHPK & BIOMETRIC ALBANIA SHPK, në datën 05.06.2024, ka paraqitur shkresën protokolluar me tonën me nr. 1227/5 prot., datë 06.06.2024 me objekt “Shtim argumentash në vijim të ankesës nr. A/2024/4099, datë 17.05.2024”.

II.10. Komisioni i Prokurimit Publik me anë të shkresës nr. 1227/6, datë 07.06.2024, i është drejtuar autoritetit kontraktor të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, dorëzimin e mostrave të paraqitura nga OE “TRIMED” SHPK së bashku me dokumentacionin shoqëruar si dhe procesverbalin e mbajtur nga AK për administrimin e tyre, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e kësaj shkrese.

II.10 Me shkresën nr. 742/3, datë 11.06.2024, protokolluar me tonën 1227/7 prot, datë 12.06.2024, autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionin e Prokurimit Publik, informacionin lidhur me kërkesën e Komisionit të Prokurimit Publik nr. 1227/6, datë 07.06.2024 për dorëzimin e mostrave.

II.11 Nga verifikimet e kryera, në datën 23.05.2024 protokolluar me tonën me nr. 1227/3 prot., operatori ekonomik “TRIMED” SHPK rezulton se ka paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit

Publik argumente si subjekt i interesuar lidhur me ankesën e paraqitur nga BOE “MONTAL” SHPK & BIOMETRIC ALBANIA SHPK sipas parashikimeve të nenit 113 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

II.12. Me shkresën nr. 1227/8 prot., datë 08.08.2024, Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtua palëve, për zhvillimin e një seance dëgjimore, në mjediset e institucionit të KPP-së, me përfaqësues ekspert fushe të *operatorit ekonomik “TRIMED” SHPK* si dhe përfaqësues ekspert fushe, anëtarë të njësisë së *Komisionit të Vlerësimit të Ofertave*, nga ana e autoritetit kontraktor, të cilët ka qenë pjesë e grupit të punës të ngritur për vlerësimin e procedurës së prokurimit objekt ankimi.

II.13. Në seancën dëgjimore të datës 13.08.2024 të zhvilluar në mjediset e KPP-së në prani të anëtarëve të Komisionit të Prokurimit Publik, u paraqitën përfaqësuesit e operatorit ekonomik “TRIMED” SHPK ( Z. A. Sh dhe Znj. Xh. V.) dhe përfaqësues nga autoriteti kontraktor Spitalit Rajonal Durrës, me detyrë juriste Znj. V.Gj, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, me detyrë kirurg Z. Sh.F. në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Hartimit të specifikimeve teknike në procedurën e prokurimit objekt-ankimi si dhe Znj. E. K. me detyrë juriste. Përfaqësuesit e operatorit ekonomik ankimues dhe të autoritetit kontraktor nuk kishin ndonjë kontestim gjatë seancës dëgjimore. Seanca dëgjimore u regjistrua në audio.

### III

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor.

#### **Arsyeton**

III.1. Lidhur me pretendimet e BOE “MONTAL” SHPK & BIOMETRIC ALBANIA SHPK, mbi kundërshtimin e kualifikimit të operatorit ekonomik “TRIMED” SHPK nga procedura e prokurimit “[...i kërkojmë komisionit të shqyrtimit të ankesave që të kryejë verifikimin e dokumentacionit të konformitetit CE apo FDA të paraqitur nga OE Trimed në lidhje me produktet e cituara në formular ankese (16, 2-24, 27, 70, 71, 72, 112, 113, 114, 120, .....]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në dokumentet e tenderit, Shtojca 7 “*Kriteret e veçanta të kualifikimit*”, pika 2.3.3, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri:

#### **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

#### **TË NJËJTA PËR TË GJITHA LOTET**

#### **2.3 Kapaciteti teknik: TË NJËJTA PËR TË DYJA LOTET**

- 1) Vetedeklarim se te gjitha materialet mjekesore nga ofertuesi (distributori/prodhuesi) jane certifikuar/markuara CE/FDA.
- 2) Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga kompania prodhuese ose nga Distributor të Autorizuar nga prodhuesi, për Shqipërinë, për këtë procedurë prokurimi, për tregëtimin e artikujve të ofruar per periudhen që përfshin objekti i prokurimit.

Shënim: Në rastin e distributorit të autorizuar për Shqipërinë të provohet lidhja me prodhuesin nëpërmjet dokumentacionit përkatës.

- 3) Vetedeklarim i operatorit ekonomik lidhur me origjinen e mallit, ku te percaktohet qarte vendi dhe kompania prodhuese.
  - 4) Vetedeklarim i OE ku deklaron se disponon te gjithë sasine per secilen nga materialet e kerkuara nga AK dhe do ta vere ne dispozicion te Autoritetit sipas kerkesave te ketij te fundit.
  - 5) Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim të vlefshëm të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në fushën e objektit të prokurimit.
  - 6) Kërkohen të paraqiten katalogë teknikë për të gjithë artikujt e ofruar. Në katalogë, artikujt dhe specifikimet teknike të tyre duhet të markohen me ngjyrë të ndezur sipas numrit rendor të përcaktuar në formularin e ofertës. (Katalogët duhet të ngarkohen në [ëëë.app.gov.al](http://ëëë.app.gov.al) së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DT.
  - 7) Kërkohen të paraqiten mostra për të gjithë artikujt e ofruar. Dorëzimi i Kampioneve/ mostrave të bëhet pranë Spitalit Rajonal Durres, të mbyllura me ngjithëse në zarf/a ose kuti jo transparente të vulosur/a, mbi të cilin/at të shënohet: “Mos e hapni me përjashtim te rasteve kur është i pranishëm Komisioni i Vlerësimit te Ofertave të kësaj procedure prokurimi dhe te dorezohen ne oren dhe daten e hapjes se tenderit (sipas njoftimit te kontrates)
- Së bashku me mostrat ofertuesi duhet të japë edhe një shkresë të vulosur dhe firmosur ku të listohen mostrat që ndodhen në zarf/kuti.
  - Në paketimin e çdo mostre duhet të evidentohet qartë origjina e mallit e cila duhet të përputhet me origjinën e deklaruar nga ofertuesi në formularin e ofertës

### **Shënim për operatorët ekonomikë:**

Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetedeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, do t'i kërkojë ofertuesit fitues nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të kërkuara sipas Shtojcës 8 të DST. Mosparaqitja e dokumentacionit përmbushës për këto pika do të jetë kusht skualifikimi.

Autoriteti Kontraktor mund të beje verifikimin e dokumentacionit në perputhje me vetëdeklarimin e bere gjate fazes se ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar perben kusht skualifikimi.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose t'i kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik “TRIMED” SHPK, rezulton, se ka paraqitur në SPE, në përmbushje të kriterit të sipërcituar:

-Katalogu\_Durrës pdf;

-Certifikime\_Durrës pdf;

-Letë konformiteti EU\_2023-607 ORIPLAST\_Gmbh pdg;

-Letër autorizimi pdf; (nga prodhuesi Shenzhen Amydi-med Electrics Tech Co Ltd, AQUA MEDICAL General management, Besdata Technology Co Ltd,

-Autorizim për tregtim me shumicë të pajisjeve mjekësore Nr. 14/14 datë 04.12.2023 pdf; Detrol healthcare kimua Sanayi as, F. Bosch International Limited, Evfarm shpk, Fortune medical Instrument corp, Galamed Corporation, GCE sro Zizkova, Geotek Medikal ve Saglik Hizmetleri Tic.San.Ltd.Sti,Good Idea Promotion Limited, Tianjin Grand Paper Industry Co Ltd, GVS Filter Technology Spa, J.Mitra&Bros, Jiangsu Ripe Medical Instrument Technology Co Ltd; Medi-tech Devixes Pvt Ltd, Mil Laboratories Pvt Ltd, Oriplast GmbH, Plasti-med Ltd Sti, Seyitler Kimya Sanayi a.s., Suzhou Sinomed Co Ltd, Stema Medizintechnik GmbH, Strimed medical Devices Pvt Ltd, Yangzhou Super Union Import& export Co Ltd, Yasemin Medilak Malzemeleri Tic.san.a.s, Deltalab sl,

-Deklaratë mbi origjinën e mallit dhe kompanitë prodhuese për secilin artikull pdf;

-Formular Përmbledhës së vetëdeklarimit pdf;

-Formular t sasisë dhe grafikut të lëvrimit pdf;

-Deklaratë nga operatori ekonomik “TRIMED” SHPK mbi furnizuesit, të cilët janë konform Standardeve të Cilësisë pdf;

- Deklaratë nga operatori ekonomik “TRIMED” SHPK mbi të gjitha materialet mjekësore janë nga ofertues (distributor/prodhues) janë certifikuar/markuar CE/FDA pdf;

- Deklaratë nga operatori ekonomik “TRIMED” SHPK mbi disponueshmërisë e gjithë sasisë së mallit pdf;

III.1.3. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe

*jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.1.4. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme”: *“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

III.1.5. Në nenin 77 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

*2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.*

*Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.*

*3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.*

*Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

*Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.*

*Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu*



referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

Ndërsa në nenin 79, po këtu thuhet se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

2. Autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dorëzimin e certifikatave ose dokumenteve të ngjashme, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, veçanërisht sa i takon:

- a) garantimit të aksesit të personave me aftësi të kufizuara;
- b) efikasitetit të energjisë;
- c) sistemeve të menaxhimit mjedisor.

3. Në rastet kur operatori ekonomik provon se nuk mund të pajiset me një certifikatë të tillë brenda një kohe të arsyeshme për arsye që nuk varen prej tij, autoriteti ose enti kontraktor mund të pranohet dokumente të tjera, nëpërmjet të cilave mund të provohet garantimi i standardeve të kërkuara.

4. Në çdo rast, certifikatat e kërkuara duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.

III.1.6. Në nenin 92 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohet, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.

2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet.

3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.

III.1.7. Në nenin 40, pika 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose

c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

III.1.8. Në nenin 44 “Kërkesat e cilësisë” të VKM nr. 285 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar parashikohet se: “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të

*njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.*

III.1.9. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt-prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/ kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues, i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt - prokurimi.

III.1.10. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm

kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton, se për përmbushjen e kriterit 2.3 kapaciteti teknik (*pikat nga 2-7*) të kriterëve të veçanta të kualifikimit, si më sipër cituar, operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar,

*-Katalogu\_Durrës pdf;*

*-Certifikime\_Durrës pdf;*

*-Letë konformiteti EU\_2023-607 ORIPLAST\_Gmbh pdg;*

*-Letër autorizimi pdf; (nga prodhuesi Shenzhen Amydi-med Electrics Tech Co Ltd, AQUA MEDICAL General management, Besdata Technology Co Ltd,*

*-Autorizim për tregtim me shumicë të pajisjeve mjekësore Nr. 14/14 datë 04.12.2023 pdf; Detro healthcare kimua Sanayi as, F. Bosch International Limited, Evfarm shpk, Fortune medical Instrument corp, Galamed Corporation, GCE sro Zizkova, Geotek Medikal ve Saglik Hizmetleri Tic.San.Ltd.Sti,Good Idea Promotion Limited, Tianjin Grand Paper Industry Co Ltd, GVS Filter Technology Spa, J.Mitra&Bros, Jiangsu Ripe Medical Instrument Technology Co Ltd; Medi-tech Devixes Pvt Ltd, Mil Laboratories Pvt Ltd, Oriplast GmbH, Plasti-med Ltd Sti, Seyitler Kimya Sanayi a.s., Suzhou Sinomed Co Ltd, Stema Medizintechnik GmbH, Strimed medical Devices Pvt Ltd, Yangzhou Super Union Import& export Co Ltd, Yasemin Medilak Malzemeleri Tic.san.a.s, Deltalab sl,*

*-Deklaratë mbi origjinën e mallit dhe kompanitë prodhuese për secilin artikull pdf;*

*-Formular Përmbledhës së vetëdeklarimit pdf;*

*-Formular të sasisë dhe grafikut të lëvrimit pdf;*

*-Deklaratë nga operatori ekonomik "TRIMED" SHPK mbi furnizuesit, të cilët janë konform Standardeve të Cilësisë pdf;*

*- Deklaratë nga operatori ekonomik "TRIMED" SHPK mbi të gjitha materialet mjekësore janë nga ofertues (distributor/prodhues) janë certifikuar/markuar CE/FDA pdf;*

*- Deklaratë nga operatori ekonomik "TRIMED" SHPK mbi disponueshmërisë e gjithë sasisë së mallit pdf;*

dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike, duke i rezervuar në këtë mënyrë të drejtën autoritetit kontraktor të kryejë verifikime në rast nevojë apo të dërgojë kërkesa për sqarim mbi dokumentacionin e paraqitur nga operatori ekonomik. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE, Komisioni konstaton, se operatori ekonomik "TRIMED" SHPK në dorëzimin e vetëdeklarimeve të kërkuara, ka plotësuar të gjitha kërkesat që parashikon kriteri teknik për kualifikim, konkretisht ka vetdeklaruar se: të gjitha materialet mjekësore nga ofertuesi (distributori/prodhuesi) janë certifikuar/markuara CE/FDA, lidhur me origjinën e mallit, ku percaktohet qartë vendi dhe kompania prodhuese, disponon të gjithë sasinë për secilën nga materialet e kërkuara nga AK dhe do ta verë në dispozicion të Autoritetit sipas kërkesave të këtij të fundit. Pra, si përfundim, lidhur me mënyrën e plotësimit të këtyre pikave të kapacitetit teknik, autoriteti kontraktor ka kërkuar që do të përmbushen me anë të një dokumenti vetëdeklarim nga ana e ofertuesit. Akoma më tej, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është me vend të theksojë rolin e posaçëm që ka autoriteti kontraktor, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin, se

dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit objekt - shqyrtimi, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm. KPP gjykon se, në lidhje me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues, mbi mungesën e disponueshmërinë e disa prej certifikimeve CE/FDA të disa materialeve mjekësore (artikujve të cituar në formular ankese) nga ofertuesi (distributori/prodhuesi), në rastin konkret nga ana e operatorit ekonomik “TRIMED” SHPK, nuk është në përputhje me kriteret e kualifikimit të vendosura nga autoriteti kontraktor për plotësimin e këtyre kapaciteteve, pasi nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe informacionit të ardhur nga autoriteti kontraktor për procedurën e prokurimit objekt-ankimi, nuk rezulton që ky i fundit të këtë kërkuar paraqitjen e tyre në këtë fazë procedurale, por ka kërkuar që të përmbushet me anë të një vetëdeklarimit nga ana e ofertuesit. Për më tepër, KPP vëren, se legjislacioni i prokurimit publik i njeh të drejtën autoritetit kontraktor, por dhe vetë ky i fundit ka rezervuar në dokumentet standarde të tenderit edhe të drejtën e verifikimit apo sqarimit nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës lidhur me vërtetësinë dhe saktësinë e informacionit që përmbajnë dokumentet e paraqitura nga ata dhe më pas të marrë vendim lidhur me to. Në këto kushte, Komisioni gjykon, se kualifikimi i operatori ekonomik “TRIMED” SHPK nga ana e autoritetit kontraktor është i drejtë, në lidhje me këto vetëdeklarime të kërkuara sipas kriterit të kapacitetit teknik 2.3. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është me vend të theksojë rolin e posaçëm që ka autoriteti kontraktor, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t’u siguruar nëse cilësia e punëve/mallrave/shërbimeve është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë. Akoma më tej, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është me vend të theksojë rolin e posaçëm që ka autoriteti kontraktor, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet t’i kërkojë ofertuesit të kualifikuar, *i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit dorëzimit e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të VKM-së 285*, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin, për t’u siguruar nëse cilësia e shërbimit, punës apo mallit është e njëjtë me cilësinë e premtuar në momentin apo fazën e ofertimit. Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, plotëson kërkesat e pikës 2.3 (të vetëdeklarimeve nga ofertuesi), e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm.

Për sa më sipër, pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e BOE “MONTAL” SHPK & BIOMETRIC ALBANIA SHPK, mbi kundërshtimin e kualifikimit të operatorit ekonomik “TRIMED” SHPK nga procedura e prokurimit *“[...]i kërkojmë komisionit të shqyrtimit të ankesave që kryejë verifikimet përkatëse në katalogët teknike për sa i përket plotësimit të specifikimeve teknike, të paraqitura nga OE Trimed*

në lidhje me produktet e cituara në formular ankese (83, 84, 103, 125, 22, 10-15, 18, 27, .....]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në dokumentet e tenderit, Shtojca 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.3, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri:

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **TË NJËJTA PËR TË GJITHA LOTET**

#### **2.3 Kapaciteti teknik: TË NJËJTA PËR TË DYJA LOTET**

- 1) Vetedeklarim se të gjitha materialet mjekesore nga ofertuesi (distributori/prodhuesi) janë certifikuar/markuara CE/FDA.
  - 2) Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga kompania prodhuese ose nga Distributor të Autorizuar nga prodhuesi, për Shqipërinë, për këtë procedurë prokurimi, për tregëtimin e artikujve të ofruar për periudhën që përfshin objekti i prokurimit.
  - 3) Shënim: Në rastin e distributorit të autorizuar për Shqipërinë të provohet lidhja me prodhuesin nëpërmjet dokumentacionit përkatës.
  - 4) Vetedeklarim i operatorit ekonomik lidhur me origjinën e mallit, ku të përcaktohet qarte vendi dhe kompania prodhuese.
  - 5) Vetedeklarim i OE ku deklaron se disponon të gjithë sasine për secilin nga materialet e kerkuara nga AK dhe do ta vë në dispozicion të Autoritetit sipas kërkesave të këtij të fundit.
  - 6) Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim të vlefshëm të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në fushën e objektit të prokurimit.
  - 7) Kërkohen të paraqiten katalogë teknikë për të gjithë artikujt e ofruar. Në katalogë, artikujt dhe specifikimet teknike të tyre duhet të markohen me ngjyrë të ndezur sipas numrit rendor të përcaktuar në formularin e ofertës. (Katalogët duhet të ngarkohen në [ëëë.app.gov.al](http://ëëë.app.gov.al) së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DT.
  - 8) Kërkohen të paraqiten mostra për të gjithë artikujt e ofruar. Dorëzimi i Kampioneve/ mostrave të bëhet pranë Spitalit Rajonal Durres, të mbyllura me ngjitëse në zarf/a ose kuti jo transparente të vulosur/a, mbi të cilin/at të shënohet: “Mos e hapni me përjashtim të rasteve kur është i pranishëm Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të kësaj procedure prokurimi dhe të dorëzohen në orën dhe datën e hapjes së tenderit (sipas njoftimit të kontratës)
- Së bashku me mostrat ofertuesi duhet të japë edhe një shkresë të vulosur dhe firmosur ku të listohen mostrat që ndodhen në zarf/kuti.
  - Në paketimin e çdo mostre duhet të evidentohet qartë origjina e mallit e cila duhet të përputhet me origjinën e deklaruar nga ofertuesi në formularin e ofertës

#### **Shënim për operatorët ekonomikë:**

Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, do t'i kërkojë ofertuesit fitues nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të kërkuara sipas Shtojcës 8 të DST. Mosparaqitja e dokumentacionit përmbushës për këto pika do të jetë kusht skualifikimi.

Autoriteti Kontraktor mund të beje verifikimin e dokumentacionit në perputhje me vetedeklarimin e bere gjate fazes se ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar perben kusht skualifikimi.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose t'i kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

#### Shtojca 5.

### FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

#### Blerje materiale mjekesore per 12 Muaj e ndare ne 2(dy) lote”,

#### **Lot 1** Materiale mjekesore te pergjithshme

| Nr   | Artikulli                    | Specifikime teknike   | Njësia | Planifikimi per 12 pas perfundimit te MK aktuale |
|--|------------------------------|---|--------|--|
| <b>Garza, Bende, te tjera konsumable te pergjithshme</b> |                              |   |        |  |
| 10   | Komprese sterile 5cm x 5cm   | 100% pamb absorbent, dendesia 24x20, 6pala; jo me shume se 5 cope/pako        | Copë   | 600  |
| 11   | Komprese sterile 10cm x 10cm | 100% pamb absorbent, dendesia 24x20, 12pala; jo me shume se 5 cope/pako       | Copë   | 600  |
| 12   | Komprese sterile 10cm x 20cm | 100% pamb absorbent, dendesia 24x20, 8pala; jo me shume se 5 cope/pako        | Copë   | 600  |
| 13   | Komprese sterile 10cm x 20cm | 100% pamb absorbent, dendesia 24x20, 12pala; jo me shume se 5 cope/pako       | Copë   |  |
| 14   | Komprese sterile 10cm x 10cm | 100% pamb absorbent, dendesia 24x20, 16pala; paketim individual (1 cope/pako) | Copë   |  |

|                           |                              |   |      |         |
|---------------------------|------------------------------|---|------|---------|
| 15                        | Komprese sterile 10cm x 10cm | 100% pamb absorb., dend. 24x20, 6ply; jo me shume se 5 cope /pako   | Copë |         |
| 18                        | Garze abdominale             | Garze sterile, e detektueshme nga rrezet-x, 100% pambuk absorbent, me 6 pala, dimensiononi i nje pale 45x45cm, dendesia 28x28, me funde te qepura, me lak lidhes, jo me shume se 5 cope per pako  | Copë | 3,600   |
| 22                        | Pulla injeksioni             | Dimensionet e peraferta: 0.9 cm x 3.8 cm , me garze perthithese ne mes dhe dy anet me ngjites antialergjik  | Copë | 1,200   |
| <b>Sisteme dhe doreza</b> |                              |   |      |         |
| 27                        | Sisteme infuzioni            | Sistem infuzioni transparente dhe fleksibel e pershtatshme si per shishet edhe per qeset e infuzionit, e pajisur me valvol ajrimi + filter + age , luer luck + bashkuese e gomuar ne forme "Y" ose "flashball" , me PP floë rregullator , 20 pika / 1ml , e paketuar me qese te sterilizuar . | Copë | 360,000 |
| 83                        | Kateter aspirimi pediatrik   | Ch 8, 10  | Copë | 3,600   |
| 84                        | Kateter aspirimi adult       | Ch 12, 14, 16, 18.  | Copë | 4,800   |
| 103                       | Leter printeri fotografike   |   | Copë | 60      |
| 125                       | Set reanimimi neonatal       | Sistem nje perdorimesh me manometer, per krijimin e presionit pozitiv ne salle te lindjes, per monitorim PEEP-PIP tek te porsalindurit premature.   | Copë | 40      |

III.2.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik “TRIMED” SHPK, rezulton, se ka paraqitur në SPE, në përmbushje të kriterit të sipërcituar:

-Katalogu\_Durrës pdf;

-Certifikime\_Durrës pdf;

-Letë konformiteti EU\_2023-607 ORIPLAST\_GmbH pdg;

-Letër autorizimi pdf; (nga prodhuesi Shenzhen Amydi-med Electrics Tech Co Ltd, AQUA MEDICAL General management, Besdata Technology Co Ltd,

-Autorizim për tregtim me shumicë të pajisjeve mjekësore Nr. 14/14 datë 04.12.2023 pdf; Detto healthcare kimua Sanayi as, F. Bosch International Limited, Evfarm shpk, Fortune medical Instrument corp, Galamed Corporation, GCE sro Zizkova, Geotek Medikal ve Saglik Hizmetleri Tic.San.Ltd.Sti,Good Idea Promotion Limited, Tianjin Grand Paper Industry Co Ltd, GVS Filter Technology Spa, J.Mitra&Bros, Jiangu Ripe Medical Instrument Technology Co Ltd; Medi-tech Devixes Pvt Ltd, Mil Laboratories Pvt Ltd, Oriplast GmbH, Plasti-med Ltd Sti, Seyitler Kimya Sanayi a.s., Suzhou Sinomed Co Ltd, Stema Medizintechnik GmbH, Strimed medical Devices Pvt Ltd, Yangzhou Super Union Import& export Co Ltd, Yasemin Medilak Malzemeleri Tic.san.a.s, Deltalab sl,

-Deklaratë mbi origjinën e mallit dhe kompanitë prodhuese për secilin artikull pdf;

-Formular Pëmbledhës së vetdeklarimit pdf;

-Formular t sasisë dhe grafikut të lëvrimit pdf;



-Deklaratë nga operatori ekonomik “TRIMED” SHPK mbi furnizuesit, të cilët janë konform Standardeve të Cilësisë pdf;

- Deklaratë nga operatori ekonomik “TRIMED” SHPK mbi të gjitha materialet mjekësore janë nga ofertues (distributor/prodhues) janë certifikuar/markuar CE/FDA pdf;

- Deklaratë nga operatori ekonomik “TRIMED” SHPK mbi disponueshmërisë e gjithë sasisë së mallit pdf;

-Nga informacioni i dërguar, autoriteti informon se ofertuesi TRIMED SHPK ka dorëzuar mostrat e kërkuara sipas specifikimeve teknike të DST dhe Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka mbajtur një procesverbal për administrimin e tyre.

III.2.3. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.2.4. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme”: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.2.5. Në nenin 77 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

*Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.*

*3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.*

*Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

*Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.*

*Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.*

*Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.*

*4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

*Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*

*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*

*5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.*

*Ndërsa në nenin 79, po këtu thuhet se:*

*1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.*

*Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.*

2. Autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dorëzimin e certifikatave ose dokumenteve të ngjashme, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, veçanërisht sa i takon:

- a) garantimit të aksesit të personave me aftësi të kufizuara;
- b) efikasitetit të energjisë;
- c) sistemeve të menaxhimit mjedisor.

3. Në rastet kur operatori ekonomik provon se nuk mund të pajset me një certifikatë të tillë brenda një kohe të arsyeshme për arsye që nuk varen prej tij, autoriteti ose enti kontraktor mund të pranojë dokumente të tjera, nëpërmjet të cilave mund të provohet garantimi i standardeve të kërkuara.

4. Në çdo rast, certifikatat e kërkuara duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.

III.2.6. Në nenin 92 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkojë, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.

2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet.

3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.

III.2.7. Në nenin 40, pika 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

6. Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor.

*Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose*

*c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.*

III.2.8. Në nenin 44 “Kërkesat e cilësisë” të VKM nr. 285 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar parashikohet se: “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

III.2.9. Në nenin 36 “Specifikimet teknike” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se:

*“1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.*

*Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.*

*Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.*

*Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.*

*2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.*

*3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:*

*a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;*

*b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve*

të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor”

III.2.10. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt-prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr.

162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/ kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues, i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt - prokurimi.

III.2.11. Referuar legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e specifikimeve teknike ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor, për sigurimin e produktit sa më cilësor, me qëllim realizimin me sukses të kontratës dhe përmbushjen e nevojave. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj, autoriteti kontraktor përcakton specifikimet teknike, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Në rastin konkret, KPP vëren, se baskimi i operatorëve ekonomikë ankimues në lidhje me dokumentin me emërtimin *katalog pdf*, të operatorit ekonomik TRIMED SHPK, pretendon se për produktet e cituara në formular ankese (83, 84, 103, 125, 22, 10-15, 18, 27) nuk përmbushin specifikimet teknike sipas shtojcës 5 të DT.

Për shkak të specifikës së procedurës së prokurimit dhe nivelit të ekspertizës së saj, përpara vijimit me hapa të tjerë procedurale, KPP ka vendosur të thërrasë në këtë seancë dëgjimore autoritetin kontraktor dhe operatorin ekonomik ankimues në lidhje me sqarimin e fakteve dhe rrethanave të ankesës së bashkimit të operatorëve ekonomikë mbi artikujt e ofertuar nga operatori ekonomik subjekt i interesuar TRIMED SHPK dhe dëgjimit të autoritetit kontraktor. Konkretisht nga ana e Komisionit, pasi u shqyrtua ankesa e ankimuesit është konstatuar, se pretendimet që ngre operatori ekonomik janë në dokumentin me emërtimin “*katalog pdf*”, të ngarkuar nga operatori ekonomik subjekt i interesuar TRIMED SHPK në sistemin e prokurimeve elektronike. Në lidhje me këto pretendime, KPP i ftoi palët në procesin administrativ me nr. 1227 prot, duke zhvilluar një seancë dëgjimore me datë 13.08.2024. Komisioni iu drejtua palëve në këtë seancë nëse ka kërkesa paraprake prej tyre, dhe nuk pati asnjë kërkesë paraprake nga ana e tyre.

Në lidhje me pretendimet e ankimuesit, Komisioni iu drejtua operatorit ekonomik “TRIMED” SHPK, si dhe autoritetit kontraktor, konkretisht ekspertëve të fushës, anëtarë të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi mënyrën e përmbushjes së këtij kriteri.

Pyetje drejtuar operatorit ekonomik “TRIMED” SHPK: “Komisionit të Prokurimit Publik i shfaqet nevoja e informacionit nga ana juaj si subjekt i interesuar, konkretisht:

- ***Për artikullin Nr. 10 “Kompresë sterile 5cm x 5cm”, Nr. 11 “Kompresë sterile 10cm x 10cm”, Nr. 12 “Kompresë sterile 10cm x 20cm”, Nr. 13 “Kompresë sterile 10cm x 20cm”, Nr. 14 “Kompresë sterile 10cm x 10cm”, Nr. 15 “Kompresë sterile 10cm x 10cm”***

*të na tregoni se, në cilën faqe të katalogut respektiv të ngarkuar prej jush në sistemin e prokurimit elektronik SPE (Katalogu\_Durrës pdf)), keni markuar specifikimin teknik të kërkuar?*

Operatori ekonomik “TRIMED” SHPK ka hapur dokumentin me emërtimin “katalogu\_Durrës pdf” në faqen nr. 60, në të cilin evidenton përmbushjen e specifikimit teknik për artikullin Nr. 10 “Kompresë sterile 5cm x 5cm”, Nr. 11 “Kompresë sterile 10cm x 10cm”, Nr. 12 “Kompresë sterile 10cm x 20cm”, Nr. 13 “Kompresë sterile 10cm x 20cm”, Nr. 14 “Kompresë sterile 10cm x 10cm”, Nr. 15 “Kompresë sterile 10cm x 10cm”.

Komisioni iu drejtua edhe përfaqësuesëve të autoritetit kontraktor në lidhje me këtë pikë dhe nuk pati pretendime.

- ***Për artikullin Nr. 18 “Garze abdominale” të na tregoni se, në cilën faqe të katalogut respektiv të ngarkuar prej jush në sistemin e prokurimit elektronik SPE (Katalogu\_Durrës pdf)), keni markuar specifikimin teknik të kërkuar?***

Operatori ekonomik “TRIMED” SHPK ka hapur dokumentin me emërtimin “katalogu\_Durrës pdf” në faqen nr. 61.

Komisioni iu drejtua edhe përfaqësuesëve të autoritetit kontraktor në lidhje me këtë pikë dhe nuk pati pretendime.

- ***Për artikullin Nr. 22 “Pulla injeksioni” të na tregoni se, në cilën faqe të katalogut respektiv të ngarkuar prej jush në sistemin e prokurimit elektronik SPE (Katalogu\_Durrës pdf)), keni markuar specifikimin teknik të kërkuar?***

Operatori ekonomik “TRIMED” SHPK ka hapur dokumentin me emërtimin “katalogu\_Durrës pdf” në faqen nr. 55, në të cilin evidenton përmbushjen e specifikimit teknik për artikullin e kërkuar.

Komisioni iu drejtua edhe përfaqësuesëve të autoritetit kontraktor në lidhje me këtë pikë dhe nuk pati pretendime.

- ***Për artikullin Nr. 27 “Sisteme infuzioni” të na tregoni se, në cilën faqe të katalogut respektiv të ngarkuar prej jush në sistemin e prokurimit elektronik SPE (Katalogu\_Durrës pdf)), keni markuar specifikimin teknik të kërkuar?***

Operatori ekonomik “TRIMED” SHPK ka hapur dokumentin me emërtimin “katalogu\_Durrës pdf” në faqen nr. 70, në të cilin evidenton përmbushjen e specifikimit teknik për artikullin e kërkuar.

Komisioni iu drejtua edhe përfaqësuesëve të autoritetit kontraktor në lidhje me këtë pikë dhe nuk pati pretendime.

- ***Për artikullin Nr. 83 “Kateter aspirimi pediatrik” të na tregoni se, në cilën faqe të katalogut respektiv të ngarkuar prej jush në sistemin e prokurimit elektronik SPE (Katalogu\_Durrës pdf)), keni markuar specifikimin teknik të kërkuar?***

Operatori ekonomik “TRIMED” SHPK ka hapur dokumentin me emërtimin “katalogu\_Durrës pdf” në faqen nr. 71, në të cilin evidenton përmbushjen e specifikimit teknik për artikullin e kërkuar.

Komisioni iu drejtua edhe përfaqësuesëve të autoritetit kontraktor në lidhje me këtë pikë dhe nuk pati pretendime.

- ***Për artikullin Nr. 84 “Kateter aspirimi adult” të na tregoni se, në cilën faqe të katalogut respektiv të ngarkuar prej jush në sistemin e prokurimit elektronik SPE (Katalogu\_Durrës pdf)), keni markuar specifikimin teknik të kërkuar?***

Operatori ekonomik “TRIMED” SHPK ka hapur dokumentin me emërtimin “katalogu\_Durrës pdf” në faqen nr. 71, në të cilin evidenton përmbushjen e specifikimit teknik për artikullin e kërkuar.

Komisioni iu drejtua edhe përfaqësuesëve të autoritetit kontraktor në lidhje me këtë pikë dhe nuk pati pretendime.

- ***Për artikullin Nr. 103 “Leter printeri fotografike” të na tregoni se, në cilën faqe të katalogut respektiv të ngarkuar prej jush në sistemin e prokurimit elektronik SPE (Katalogu\_Durrës pdf)), keni markuar specifikimin teknik të kërkuar?***

Operatori ekonomik “TRIMED” SHPK ka hapur dokumentin me emërtimin “katalogu\_Durrës pdf” në faqen nr. 78, në të cilin evidenton përmbushjen e specifikimit teknik për artikullin e kërkuar, në rastin konkret artikulli me emërtimin X-Ray Film, në varësi të modelit dhe brendit të printerit dhe është i njëjtë me artikullin me emërtimin “Leter printimi fotografike”.

Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtua edhe përfaqësuesëve të autoritetit kontraktor në lidhje me këtë pikë, nëse artikulli i kërkuara nr. 103 “Leter printeri fotografike” a është i njëjti me artikullin me emërtimin “X-Ray Film” i ofruar nga operatori ekonomik TRIMED SHPK?



Komisioni sjell në vëmendjen tuaj, që artikulli i kërkuar me nr. 103 “Leter printeri fotografike” gjendet në seksionin “Materiale konsumi për monitorim diagnostike”. Një nga pretendimet e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimes është në lidhje me faktin që operatori ekonomik TRIMED SHPK nuk ka dorëzuar “Leter printeri fotografike” por ka dorëzuar letër për “X-Ray Film”.

**Përgjigjia e përfaqësuesit të autoritetit kontraktor:** *“Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike nuk ka bërë specifikime teknike për këtë zë, dhe sipas komisionit të vlerësimit të ofertave është parë që janë po e njëjta gjë.*

Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtua dhe ekspertit të fushës përfaqësues i autoritetit kontraktor, doktorit Z. Sh.F: *“nëse brenda spektrit të punës tuaj mund të evidentoni nëse për artikullin “Leter printeri fotografike” e kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor, për cilat pajisje kërkohen dhe nëse është e njëjtë me artikullin me emërtim “X-Ray Film” të dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik?”*

**Përgjigjia e përfaqësuesit të autoritetit kontraktor (ekspert fushe):** *“Letra për X-Ray Film përdorët ose për të printuar grafi ose për letra që përdoren përmes radiologjisë ose për të printuar ekot e ndryshme. Unë mendoj që është në rregull, por nuk jam ekspert pasi jam me profesion kirurg”.*

**Përgjigjia e përfaqësuesit të operatorit ekonomik TRIMED SHPK:** *“Në lidhje më këtë artikull, nga ana e autoritetit kontraktor është lënë me specifikim të hapur”.*

- **Për artikullin Nr. 125 “Set reanimimi neonatal”** të na tregoni se, në cilën faqe të katalogut respektiv të ngarkuar prej jush në sistemin e prokurimit elektronik SPE (Katalogu\_Durrës pdf), keni markuar specifikimin teknik të kërkuar?

Operatori ekonomik “TRIMED” SHPK ka hapur dokumentin me emërtimin “katalogu\_Durrës pdf” në faqen nr. 27, paragrafi katër, në të cilin evidenton përmbushjen e specifikimit teknik për artikullin e kërkuar.

Komisioni iu drejtua edhe përfaqësuesëve të autoritetit kontraktor në lidhje me këtë pikë dhe nuk pati pretendime.

Ndërsa, në lidhje me pretendimin e ankimesit mbi arsyen e kualifikimit të bërë nga ana e autoriteti kontraktor, mbi përmbushjen e specifikimeve teknike të artikujve (83, 84, 103, 125, 22, 10-15, 18, 27), Komisioni sqaron se, referuar hartimit të kriterit dhe përmbushjes së tij, është kërkuar katalogë me të dhënat teknike sipas specifikimeve të vendosura. Për sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kualifikimi operatorit ekonomik ofertues TRIMED SHPK, është jo i drejtë pasi është bërë në kushtet ku produkti i ofruar “X-Ray Film” nuk është i njëjtë me produktin e kërkuar me emërtimin “Leter printeri fotografike”, çka nuk është në përputhje me ligjin për prokurimin publik. Palët prezent në procesin administrativ, pranuar që pavarësisht se është kërkuar produkt tjetër me emërtimin “Leter printeri fotografike”, është e

njëjtë me atë të ofruar nga ana e operatorit ekonomik TRIMED SHPK. KPP gjykon, se nëse autoriteti kontraktor do të kishte paqartësi në vlerësimin për përmbushjen e këtij kriteri, në kuptim të pikës 1, të nenit 82 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, në të cilën përcaktohet, se Komisionit të Vlerësimit të Ofertave i lind nevoja për verifikime ose ndryshime të një apo më shumë anëtarëve, afati i vlerësimit pezullohet në momentin e paraqitjes së kërkesës për verifikim apo ndryshim dhe rifillon aty ku është pezulluar, me marrjen e përgjigjes apo zyrtarizimit të anëtarit/anëtarëve. Si dhe Komisioni i Vlerësimit të Ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme. Është detyrim ligjor i subjektit ofertues, të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor, plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Akoma më tej, KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit.

Për sa më sipër, pretendimet e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues qëndrojnë pjesërisht.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

#### **Vendos:**

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “MONTAL” SHPK & BIOMETRIC ALBANIA SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar – Mallra – Prokurim me mjete elektronike, Marrëveshje kuadër me një operatorë ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat 12 muaj nga nënshkrimi”, me Nr. REF-97716-03-07-2024, me objekt: “**Blerje materiale konsumi mjekësore per 12 Muaj e ndare ne 2(dy) lote**” Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: **54.589.104** (pesedhete e kater million e peseqind e tetedhete e nente mije e njeqind e kater) leke pa T.v.sh e konvertuar në Euro, sipas kursit

zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, datë 07.03.2024: **525.552 euro pa TVSH**, **Loti 1 me Nr. REF-97720-03-07-2024**, me objekt: “**Loti 1 - Materiale mjekimi te pergjithshme per nevoja spitalore**”, me fond limit **LOT I MM1: 25.735.020 (njetete e pese milion e shtateqind e tridhjetë e pese mije e njetete) leke pa TVSH** e konvertuar në Euro, sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, datë 07.03.2024: **247.762 euro pa TVSH**, zhvilluar në datë 08.04.2024 nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Durrës.

2. Autoriteti kontraktor të rishikojë arsyet e kualifikimit të operatorit ekonomik “TRIMED” SHPK duke e skualifikur këtë të fundit dhe të korrigojë shkeljet e konstatuara si më sipër.
  3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
  4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “MONTAL” SHPK & BIOMETRIC ALBANIA SHPK.
  5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
  6. Kopje e këtij vendimi, i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Gjergj Mersini**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**

